EKSPOZITË

ME SKULPTURA TË AGIM ISLAMAJ

BIBLIOTEKA KOMBËTARE DHE UNIVERSITARE E KOSOVËS

THE NATIONAL AND UNIVERSITY LIBRARY OF KOSOVA

JAVA E BIBLIOTEKËS NË KOSOVË

16 - 21 PRILL 2007

Botues:
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Drejtor:
Prof. dr. Sali Bashota

Dizajni
extreme studio

© 2007, BKUK

Prishtinë
2007

AGIM ISLAMAJ

DY BREZA NËPËR RRATHËT E KUJTESËS

(Për skulpturat e Aziz Islamajt dhe Agim Islamajt)

Mund të krijohet një rrëfenjë poetike krejtësisht e re apo madje një kallëzim çuditërisht i bukur për dy breza skulptorësh , për Babë e Bir, të cilët u nisën dalëngadalë t'i gdhendin Shpirtrat e tyre nëpër Plasat e Drurit dhe të Gurit, duke i ringjallur format e ekzistencës dhe të qëndresës përbrenda imazhit të një realiteti të përjetuar. Pra, është Atdheu, Koha, Hapësira, Ëndrra, Ideali etj., që projektohen fuqishëm në botën krijuese të këtyre dy skulptorëve, pikërisht aty ku valëvitet, sa herë, e ndodhura historike nëpër rrathët e kujtesës, nëpër rrathët e identitetit, nëpër rrathët e realitetit, për t'u shndërruar në formulë magjike të frymës njerëzore e nacionale.

Në botën e krijuese të këtyre skulptorëve, fuqizohet gjithmonë e njëjta dhembje e formësuar dhe e shformësuar përmes gjuhës universale të skulpturës, për të depërtuar në esencën e fakteve, aty ku edhe koncepti për atdheun dhe njeriun, përplaset bashkë me shëmbëllimet e fatit nëpërmjet trajtave të gdhendura, që gjësendet i shpirtëzojnë në virtyt, për të përcaktuar absoluten e simboleve të përfytyruara deri në pafundësi.

Derisa Aziz Islamaj, i vendos dhe i zhvendos pamjet e ekzistencës në variante dhe versione, pastaj i rikrijon figurat për "me i detyrue ato me andrrue tanë jetën", Agim Islamaj më shumë skicon a portretizon abstrakten përmes vijave të trasha ndërmjet realitetit dhe irrealitetit, për t'i ringjallur pasazhet e zjarrta për dhembjen, dëshpërimin, dashurinë, a më tutje për "me e pae ftyrën e ambël të njeriut".

Skulpturat e Aziz dhe Agim Islamajt, ndër të tjera, e vizionojnë gjenealogjinë e trungut të atdheut. Megjithatë, dheu është i njëjti, po edhe toka e djegur, hiri, zogu i vrarë apo fundja gjaku me profil lirie. Në skulpturat e Aziz Islamajt mbijetojnë shpirtrat, fytyrat, gjymtyrët apo madje edhe copëzat e gdhendura, ku krijohet harmonia estetike për të sajuar format e zogut, gruas, ekzistencës, atdheut, vendlindjes etj.

Variacionet apo motërzimet e gdhendjes së druve dhe gurëve, gjithsesi, për t'u bërë monument, sikur u ngjajnë fragmenteve lirike të një poeme të pambaruar, ku flitet për një parahistori, histori, realitet apo kur përmbyset bota e miteve dhe e iluzioneve.

Përputhjet simetrike në trupin e skulpturave, sikur e rizbulojnë nyjën e fatit, atëherë kur formësohet harku i ndjenjave dhe i përjetimeve apo formësohet meditimi dhe pastaj shënjohen: imazhi i çrëndomtësuar i figurave, mbetjet, mikpritja, pushtimi i hapësirës, varret, simbolet, tradita, humanizmi. Aziz Islamaj e ka gdhendur vetminë e tij përbrenda atij zjarri imagjinar që e ndërton parabolën moderne dhe kohën e rikthyer në metaforë lirie apo në arketip shqiptar. Dialektika e formave të përsosura në skulpturat e Aziz Islamajt, ndër të tjera, shërben për të mësuar se si ndërtohen imazhet e qëndresës dhe se si përmbysen iluzionet groteske.

Ndërsa, Agim Islamaj i ka gdhendur meditimet e tij djaloshare, njëlloj si valët e shpirtit të tij, për të përfytyruar arsyen e një vezullimi të pambarimtë që po lind, i cili rrokulliset gjithmonë në një ceremoni të krismës së emrit të gdhendur si fat, që e ruan krenarinë e vet, edhe kur shënjohet jeta apo vdekja. Megjithatë, ndriçimi i formave të ekzistencës përmes vijave skulpturale, bëhet dashuri, mbrojtje, adhurim, sakrificë, pavdekësi.

Në kohën kur drurët e moçëm e prisnin dorën e skulptorëve që ata të flisnin me gjuhën e tyre, studioja e Azizit dhe Agimit digjet, bëhet shkrumb e hi. Tani prapë po rikthehet në jetë, pikërisht nga pjesët e ringjallura të kujtesës bashkë me dhembjen dhe mallin për motin e djegur në një kohë dhe në një vend.

Nga pikëshikimi im poetik veneroj se magjia e artit nis e shpërthen përbrenda botës së këtyre dy skulptorëve që i përkasin dy brezave, bashkë me shenjat e tyre të përveçme dhe autentike dhe rrëfenja mund të vazhdojë edhe në Kohën Tjetër, kur ringjallet e dëgjohet larg, shumë larg zhurma e krismave, qoftë kur gdhendet a skalitet edhe shkrumbi i mallit për botën e humbur, apo rruzullimi i shpirtit të tyre krijues në botën e përndritjeve estetike që prapë ribëhen, rishfaqen, rindërtohen.

Më në fund, Azizi dhe Agimi me skulpturën, gjithsesi, po bëjnë një ngadhënjim të veçantë, jo vetëm përbrenda artit të tyre...

Prishtinë, prill 2007 *Sali Bashota*

AGIM ISLAMAJ

AUTOBIOGRAFI

AGIM ISLAMAJ U LIND MË 4.8.1980 NË MURGË - SKËNDERAJ. KA DIPLOMUAR NË VITIN 2003 - NË DEGËN SKULPTURË, NË FAKULTETIN E ARTEVE NË PRISHTINË, NDËRSA STUDIMET PASUNIVERSITARE I KA PËRFUNDUAR NË VITIN 2005 NË TË NJËJTIN DREJTIM DHE TE I NJËJTI PROFESOR - AGIM RUDI.

EKSPOZITË PERSONALE

2003 - INSTITUTI ALBANOLOGJIK - PRISHTINË

EKSPOZITË KOLEKTIVE

2000 - NË FAKULTETIN E ARTEVE - PRISHTINË
2001 - NË FAKULTETIN E ARTEVE - PRISHTINË
2001 - "DITA E SKËNDERAJT" - SHTËPIA E KULTURËS, SKËNDERAJ
2002 - NË FAKULTETIN E ARTEVE - PRISHTINË
2002 - EKSPOZITË E PËRBASHKËT ME STUDENTËT E FAKULTETIT TË ARTEVE NË BIBLIOTEKËN FRANCEZE NË FAKULTETIN FILOLOGJIK - PRISHTINË
2002 - EKSPOZITË E PËRBASHKËT ME STUDENTËT E ARTIT FIGURATIV DHE ME STUDENTËT E ARKITEKTURËS NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS - PRISHTINË
2004 - DITA E ÇLIRIMIT TË PRISHTINËS - PRISHTINË
2005 - SALLONI I NËNTORIT - PRISHTINË
2006 - DITA E ÇLIRIMIT TË PRISHTINËS - PRISHTINË
2006 - SALLONI I NËNTORIT - PRISHTINË
2007 - FLAKA E JANARIT - GJILAN
2007 - RRUGËT E LIRISË - MUZEU I KOSOVËS - PRISHTINË

SHPËRBLIMET

NGA REKTORATI I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS MORI SHPËRBLIMIN STUDENT I DALLUAR.
NË VITIN 2006, NË EKSPOZITËN DITA E ÇLIRIMIT TË PRISHTINËS, NË PRISHTINË, IU NDA SHPËRBLIMI SI MË I MIRI NË SKULPTURË.